



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Bordi i Administrimit

Nr. 2567/prot.

Shkodër, më 19.07.2019

V E N D I M

Nr. 2567/, datë 19.07.2019

"Për pagesën e stafit me kohë të plotë, të angazhuar me veprimtari dytësore si projekte kombëtare dhe ndërkombëtare"

Bordi i Administrimit, në mbledhjen e tij të datës 19.07.2019, pasi diskutoi në lidhje me pagesën e stafeve akademike si pjesë e projekteve të fituara nga USH,

Vendosi

1. Për çdo projekt të lidhur mes Universitetit të Shkodrës apo strukturave të caktuara të saj dhe partnerëve vendas apo të huaj, të financuara nga BE, KE etj., nëse është parashikuar që kostoja për stafin pjesëmarrës është e lidhur me punën për këtë projekt, atëherë kjo shumë, në masën 70% t'i shpërndahet grupit të punës. Mënyra e shpërndarjes të përcaktohet nga vetë grupi i punës. 30% e shumës shkon për nevoja të fakultetit apo departamentit përkatës që ka lidhur marrëveshjen për projektin.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Namik KOPLIKI

